



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 342/ 5 prot.

Datë 07.03.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 252/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.03.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore*”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK me NIPT L28029301Q, me adresë: Fshati Gurëz, afër ish kanalit të Acidit, Kurbin.

Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B, me adresë: Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.  
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues “Vale Recycling ” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.02.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore*”, *Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj*”, me fond limit 12,324,510 (*dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

II.2. Në datën 13.02.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3803 dhe me nr. 342/2024 protokollit, e operatorit ekonomik “*Vale Recycling*” SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Ne datën 07.02.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur" me Nr. REF-94567-02-06-2024, me objekt Eliminimi i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore" me afat MK 12 muaj", me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) leke pa tvsh, marrëveshje Kuadër parashikuar për 12 muaj, parashikuar për t'u zhvilluar me date 02.02.2023 nga autoriteti kontraktor "Spitali Obstetrik Gjinekologjik Koco Gliozheni", Tiranë. Brenda afatit ligjor (7 ditë nga dita e publikimit të procedurës në SPE) paraqesim këtë ankese pranë AK-se dhe KPP-së persë me poshtë vijon.*

*Nga autoriteti kontraktor me publikimin e kësaj procedure prokurimi janë publikuar dhe kriteret e përgjithshme të veçanta të kualifikimit, argumentimi i secilit kriter, preventivi me zërat përkatës, volumet etj.*

*Duke qënë një procedure prokurimi e veçantë sic është procedura e prokurimit për shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, në konstatojmë se kemi kritere të veçanta kualifikimi të cilat janë diskriminuese dhe sjellin pengim të konkurrencës së lire duke rënë ndesh me parimet baze të LPP-se për sa më poshtë argumentojmë.*

*A) Në DST nga AK është kërkuar:*

*1. SHTOJCA Nr. 8*

*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.*

*2.1 Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomike:*

*"5. Vertetim që operatori ka dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, raportet e vetmonitorimeve periodike, në zbatim të kushteve të Lejes Mjedisore që disponon, Ligjit "Për Lejet e Mjedisit Nr. 10448 date 14.07.2011, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar."*

*Se pari, ky kriter nuk eshte i argumentuar, detyrim ky ligjor bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 285, date 29.9.2010 "Miratimin E Rregullave te Prokurimit Publik", ne nenin 2 pika "c" ku percaktohet : "2. Per çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet te dokumentoje te paktën:*

*a) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit.*

*Duke qene se ky kriter nuk eshte argumentuar nga AK kontraktor e kemi te veshtire te vlerësojme apo te gjejme dobine apo rritjen e cilësisë së shërbimit qe i sjell Autoritetit Kontraktor ky kriter per detyrime që operatorët ekonomik i kanë ndaj organeve qe i kanë licensuar, dhe për çfare vlerësohet i nevojshëm "vertetimi që operatori ka dorezuar prane Agjencisë Kombëtare te Mjedisit, raportet e vetmonitorimeve periodike", për ekzekutimin me sukses te kontratës.*

*Për sa më lart, duke pasur parasysh qe ky kriter nuk i shërben as performances se shërbimit dhe as garancise për realizimin e ekzekutimit me sukses te kontrates kerkojme heqjen e ketij kriteri.*

## **2. SHTOJCA Nr. 8**

### **Kriteret e Veçanta te Kualifikimit**

#### **2.1 Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomike:**

*"6. Vertetim që operatori ka kryer tarifën vjetore te Lejes Mjedisore, pranë Agjencise lejeve të Mjedisit", ne zbatim te VKM nr. 417, date 25.06.2014, "Per Miratimin e Tarifave të lejeve të Mjedisit".*

*Se pari, ky kriter nuk eshte i argumentuar, detyrim ky ligjor bazuar ne Vendimin e Këshillit te Ministrave nr.285, date 29.9.2010 "Miratimin E Rregullave te Prokurimit Publik", ne nenin 2 pika "c" ku percaktohet:*

*"2. Per do procedure prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet te dokumentoje te paktën:*

*b) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;"*

*Duke qene se dhe ky kriter nuk eshte argumentuar nga AK kontraktor e kemi te vështirë te vlerësojme apo te gjejme dobine në rritjen e cilësisë së shërbimit qe i sjell Autoritetit Kontraktor ky kriter per detyrime qe operatorët ekonomik i kane ndaj organeve qe i kanë licensuar, dhe për çfare vlerësohet i nevojshem "Vertetimi qe operatori ka kryer tarifën vietore të Lejes Mjedisore, prane Agjencise Kombetare të Mjedisit", per ekzekutimin me sukses te kontratës.*

*Per sa me lart, duke pasur parasysh qe ky kriter nuk i shërben as performances se shërbimit dhe as garancise për realizimin e ekzekutimit me sukses te kontrates kerkojme heqjen e ketij kriteri.*

## **3. SHTOJCA Nr. 8**

### **Kriteret e Veçanta te Kualifikimit**

#### **2.1 Kapaciteti profesional te operatorëve ekonomike:**

"7. Vertetim qe operatori nuk ka mase administrative ne fuqi nga strukturat inspektuese te Agjencise Kombetare te Mjedisit, ne zbatim te Ligj Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republiken e Shqiperise", Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr. 10448 date 14.07.2011 si dhe Ligjit Nr. 10 463, date 22.09.2011 "Per Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve".

Dhe ky kriter si kriteret me lart nuk eshte i argumentuar, detyrim ky ligjor bazar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 285, datë 29.9.2010 "Miratimin E Rregullave te Prokurimit Publik", në nenin 2 pika "c" ku përcaktohet: "2. Per cdo procedure prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet te dokumentoje te paktën:

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

Duke qëne se dhe ky kriter nuk eshte argumentuar nga AK kontraktor e kemi te veshtirë te vlerësojme apo te gjejme dobinë në rritjen e cilësise se sherbimit qe i sjell Autoritetit Kontraktor ky kriter për detyrime që operatoret ekonomik i kane ndaj organeve qe i kanë licensuar, dhe per cfare vleresohet i nevojshëm "Vertetimi qe operatori nuk ka mase administrative ne fuqi nga strukturat inspektuese te Agjencise Kombetare te Mjedisit", për ekzekutimin me sukses te kontrates.

Për me tepër masat administrative mund te jenë te ndryshme (penalite per vonesa ne pagesa, vonesa në dorëzimin e dokumentave te ndryshem etj) por autoritetit kontraktor nuk mund dhe nuk duhet ti interesojte qe operatori ekonomik mund te kete masa administrative te tjera përvec atyre qe lidhen direkt me llojin e sherbimit dhe per nje periudhe te caktuar, pra ky kriter duhet te ishte formular ndryshe nga autoriteti kontraktor dhe duhet ti referohej vetem masave te marra nga trupat inspektuese ndaj subjekteve te cilat kane shkaktuar dem ne mjedis, sepse vetem demi mjedisor gjate nje periudhe te caktuar (p.sh. 12 muajt e fundit) mund te jete me rendesi per AK ne varesi te objektit te prokurimit.

Per sa me lart, duke pasur parasysh qe ky kriter nuk i sherben as performances se shërbimit dhe as garancise per realizimin e ekzekutimit me sukses te kontrates kerkojme heqjen ose ndryshimin e kriterit sipas argumenteve te dhena.

#### 4. SHTOJCA NR. 8

##### Kriteret e Veçanta te Kualifikimit

##### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.8 Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjistër te posacem, minimalisht të dhenat e meposhtme:

a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;

b. sasine ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin perkatës sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;

c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;

d. temperaturën dhe presionin;

e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemër, adresë, nr. telefoni) te asgjesuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;

f. Te dhenat per lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerisë se tyre) dhe Kodin Unik te asgjesuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;"

Ky kriter si kriteret me lart nuk eshte i argumentuar, detyrim ky ligjor bazuar ne Vendimin e Këshillit te Ministrave nr.285, date 29.9.2010 "Miratimin E Rregullave te Prokurimit Publik", ne nenin 2 pika "c" ku percaktohet : "2. Per cdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojte te pakten: a) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;"

Ne këte kriter te vendosur nga AK nuk eshte percaktuar se cfare dokumenti duhet te paqesin konkretisht operatorët ekonomik, per përmbushjen e ketij kriteri.

Për sa më lartë, duke patur parasysh që ky kriter nuk i shërben as përformancës së shërbimit dhe as garancisë për realizimin e ekzekutimit me sukses të kontratës si dhe nuk është përcaktuar asnjë dokument konkret për përmbushjen e këtij kriteri heqjen e kriterit sipas argumenteve të dhëna.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.4. Me shkresën nr. 18/24 prot, datë 19.02.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 342/2 prot., datë 22.02.2024 me objekt "Vënje në dijeni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë "Vale Recycling" SHPK, nëpërmjetë së cilës ka vendosur pranimin pjesërisht me përmbajtje si më poshtë vijon:

Drejtuar: OE Vale Recycling sh.p.k

Me Adrese: Fshati Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit Kurbin

E-mai: [recycling.vale@gmail.com](mailto:recycling.vale@gmail.com)

Per dijeni: Komisionit te Prokurimit Publik

Objekti: "Eliminim i Mbetieve te Rrezikshme Spitalore", Procedure e Hapur, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj  
Fondi limit: Me fond limit 12,324,510 (dymbedhjetë milion e treqind e njëzet e kater mije e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh.

Kodi sipas Fialorit te Perbashket te Prokurimit (FPP): 90510000-5

REF- 94567-02-06-2024

I mbaitur sot me date 19.02.2024 bazuar ne urdherin Nr. 18/20 Prot, date 14.02.2024 në lidhje me objektin e prokurimit: "Eliminim mbetjesh spitalore" me fond limit 12,324,510 (dymbedhjetë milion e treqind e njëzet e kater mije e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh, për një

periudhe 12 muaj MK, procedure e deleguar nga Organi Qëndror Blerës MSHMS, nga ankesat e ardhura ne Komisionin i Prokurimit Publik me emailin e dates 13.02.2024 Njoftim per Ankesën nga Operatori Ekonomik Vale Recycling sh.p.k prane Komisionit te Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktor nepermjet specialistit te fushës te emeruar nga ana e tij vendosi te beje ndryshimet si më poshte: Bazuar në Ligjin e Prokurimit publik me Nr. 162/2020 Kreu XIV, neni 109, 110, 111, 113 dhe 114 si dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e rregullave te prokurimit publik" neni 98, 99, 100, 101, 102, 103 dhe 104 vendosi: Per Vale Recycling sh.p.k te marri parasysh pranimin e pjesshëm te ankesës. Per Piken 2.3.8 në DST merret parasysh e plota ankesa.

Shtojca 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, Shtojca 7 Formulari i Termave të Referencës pika

c. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjister te posacem, minimalisht te dhenat e meposhtme:

a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;

b. mbetjeve; sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;

c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;

d. temperaturen dhe presionin;

e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adresë, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;

f. te dhenat per lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;

Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor.

Si dhe në piken 2.3 Kapaciteti teknik, te DST-ve pika 2.3.8:

Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjister te posacem, minimalisht te dhenat e mëposhtme:

a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;

b. mbetjeve; sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;

c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;

d. temperaturen dhe presionin; e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon per asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adrese, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;

f. te dhenat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave të mbetjeve spitalore;

Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi për autoritetin kontraktor.

*Persa i perket pikes 2.1 Kapacitetin profesional te operatorëve ekonomik nuk merret parasysh nga ana e AK duke gene se plotesimi dhe pajisja nga ana e OE-ve me kete dokumentacion eshte nje detyrim ligjor dhe nuk eshte i përcaktuar nga ana e AK por nga Ministria perkatese e fushes dhe ne cdo pike eshtë e percaktuar qart baza ligjore se përse eshte kerkuara nga ana e AK pra:*

*4. Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno -Sanitar respektiv per obiekten ku ushtron aktivitetin e trajtimit te mbetjeve spitalore, te leshuar nga ISHS (Inspektoriati Shendetesor Shteteror).*

*5. Vertetim qe operatori ka dorëzuar prane Agjencise Kombetare te Mjedisit, raportet e vetmonitorimeve periodike, ne zbatim te kushteve te Lejes Mjedisore qe disponon, Ligjit "Per Lejet e Mjedisit" Nr. 10448 date 14.07.2011, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.*

*6. Vertetim qe operatori ka kryer tarifen vjetore te Lejes Mjedisore, prane Agjencise Kombetare te Mjedisit, në zbatim te VKM nr. 417, date 25.06.2014, "Per Miratimin e Tarifave te lejeve te Mjedisit"*

*7. Vertetim qe operatori nuk ka mase administrative ne fuqi nga strukturat inspektuese te Agjencise Kombetare te Mjedisit, në zbatim te Ligj Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise", Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr. 10448 date 14.07.2011 si dhe Ligjit Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"*

*Per sa me sipër ju bejme me dije se nga ana e AK jemi bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" Kreu XI, Neni 77, pika 4 si dhe VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" Seksioni III "Kerkesa te Vecanta sipas Tipeve të Kontratave", Neni 42 Kerkesa te vecanta per kontratat e shërbimeve" pika 5 germa c dhe pika 6.*

*Keto ndryshime do te reflektohen ne Shtojcen për DST dhe per këte vendim do te njoftohet KPP si dhe OE i cili ka paraqitur ankimimin, per heqjen nga pezullimi AK do te presi deri ne vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi dhe zhvillimin e metejshtëm te procedures.*

**II.5. Në datën 13.02.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3804 dhe me nr. 343/2024 protokoli, e operatorit ekonomik "Eco Riciklim" SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:**

*Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë (AK), ka publikuar me date 07.02.2024 ne SPE proceduren me objekt Eleminimi i Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore" me afat MK 12 muaj, me REF-94567-02-06-2024. Në date 08.02.2024, ne dorezuam ne SPE, nje kerkese per sqarim në lidhje me kriterin 2.3.8 te Kriteve Teknike te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit në DST. Deri ne datën e paraqitjes se kesaj ankese, nuk eshte publikuar nje pergjigje per këte kerkese tonën për sqarim, ndaj jemi te detyruar te paraqesim kete ankese,*



*me qëllim moshumbjen e afateve të ankimit. Duke e konsideruar kriterin 2.3.8 jo vetëm të paqarte, por të pamundur ligjërisht për tu aplikuar si i tillë, në paraqesim këtë ankese si vijon:*

*Ne DST është vendosur kriteri 2.3.8 si vijon: 2.3.8 Për procesin e trajtimit të mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posaçëm, minimalisht të dhënat e mëposhtme:*

- a. numrin e identifikimit të ciklit të trajtimit;*
- b. sasine ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;*
- c. datën, orën e fillimit dhe mbarimit të ciklit të trajtimit;*
- d. temperaturën dhe presionin;*
- e. subjektin/vend-depozitimitin ku dorëzon për asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore he të dhënat e kontaktit (emer, mbiemer, adresë, nr. telefoni) të asgjësuesit të këtyre tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara;*
- f. të dhënat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, të licencës III.2.B (vlefshmerisë së tyre) dhe Kodin Unik të asgjësuesit të tepricave të mbetjeve spitalore;*

*Se pari, kriteri është i paqartë dhe i paargumentuar:*

*Menyra sesi është formuluar kriteri, është e paqarte, pasi thuhet që: "kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjister të posaçëm", pra duket si detyrim që i kërkohet kontraktorit të zbatojë gjatë ekzekutimit të kontratës, dhe jo si kërkesë për kualifikim. Gjithashtu, nëse është kriter kualifikimi, nuk është e qarte menyra sesi duhet përmbushur nga OE, pasi nuk është specifikuar çfarë dokumenti konkret kërkohet të paraqitet. Gjithashtu, në proces-verbalin e argumentimit të kriterëve, nuk jepet asnjë informacion që shpjegon dhe argumenton vendosjen e këtij kriteri, ndaj dhe nga ana jone përpara ankesës u depozitua në AK edhe një kërkesë për sqarim, e cila ende nuk ka marrë përgjigje.*

*Se dyti, nëse është kriter kualifikimi, në formën sic është formuluar, është ligjërisht i pamundur: Nëse nga ana e AK kërkohet me anë të këtij kriteri që të dorëzohet një dokument ku regjistrohen transfertat e mbetjeve, sqarohet se kuadri ligjor dhe nenligjor përkatës i ka të percaktuara qartë dhe në mënyrë shteruese dokumentat dhe regjistrat që duhen mbajtur për transfertat e mbetjeve spitalore. Me konkretisht, këto janë percaktuar në:*

- Ligjin nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*
- VKM nr. 371, datë 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre";*
- VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transfertimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transfertimit";*
- Urdherin e Ministrisë të Mjedisit të Nxjerre në zbatim të tyre nr. 135, datë 16.4.2015 "Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të regjistratit të transfertave individuale dhe të regjistratit kombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre".*

*Keto akte ligjore dhe nenligjore, percaktojne me detaje te hollesishme rregullat e dokumentimit, informacionin qe duhet te perfshihet, menyren e administrimit, dhe formatin e dokumentave qe mbahen per mbetjet dhe regjistrin te transfertave individuale.*

*VKM 371/2014 de VKM 229/2014, parashikojne qe formati i regjistrin te transfertave individuale percaktohet me Urdher te Ministrit te Mjedisit. Urdheri i Ministrit te Mjedisit nr. 135, date 16.4.2015, e percakton ne Shtojcen I te tij, permbajtjen dhe elementet perberes te Regjistrin te Transfertave Individuale. Pra, kuadri ligjor dhe nenligjor i zbatueshem, (perfshire edhe VKM nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore", te Udhezuesit Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore) ka percaktuar ne menyre shterruese llojin dhe formen e dokumentacionit qe duhet mbajtur nga operatoret qe trajtojne mbetje spitalore. Ne kete kontekst, menyra sesi eshte formuluar permbajtja e Regjistrin e kerkuar nga AK, nuk reflekton permbajtjen e detyrueshme te percaktuar me Urdher Ministri, pra e ben te pamundur ligjerisht kete kriter (gjithmone nese eshte konceptuar si i tille). Gjithashtu po ky Urdher, percakton qe regjistri ruhet per nje periudhe 3 vjecare dhe dorezohet cdo 6 muaj ne AKM. Nisur nga sa me siper, gjithnje nese AK synon qe ky te jete kriter kualifikimi, duhet sqaruar sa vijon:*

*1. A eshte pikerisht Registri i Transfertave Individuale sipas VKM-ve te mesiperme, qe kerkohet te dorezohet per permbushjen e kriterit 2.3.8?*

*2. Nese po, duhet te specifikohet per cilen periudhe kerkohet te dorëzohet, per 3 vjet, apo vetem ajo e 6-mujorit te fundit dorëzuar ne AKM?*

*Nese AK nga ana tjeter ka pasur ndermend qe kjo te jete pjese e Specifikimeve Teknike apo Termave te References, pra nje detyre per tu permbushur nga OE posacerisht per kete kontrate gjate zbatimit te saj, duhet te rishikojne elementet perberes te kerkuar, per kete informacion, pasi ato dhe formati ne te cilen mbahen jane te percaktuara ne nenet 21 dhe 26 te Ligjit 10463/2011, VKM 371/2014 de VKM 229/2014. Per sa kohe Ligji 10463/2011 ia ka dhene kompetencen per te percaktuar elementet qe duhet te perfshihen ne dokumentacion dhe formatin perkates, Keshillit te Ministrave, nje AK nuk mund te marri keto kompetenca dhe te percaktojne rregulla te ndryshme me inisiativen e vet.*

*Ne rrethanat e mesiperme kerkojme:*

*1. AK te saktësoje nese pika 2.3.8 eshte kriter kualifikimi apo pjese e Specifikimeve Teknike dhe/ose Termave të References*

*2. Nese AK kerkon permbushjen e nje kriteri kualifikimi te tille, te zevendesojte ate duke kerkuar paraqitjen e Regjistrin të Transfertave Individuale, sipas percaktimit ne VKM 371 dhe VKM 229, si dhe ne Urdherin e Ministrit te Mjedisit nr. 135, date 16.4.2015, duke saktësuar edhe periudhen perkatese të kerkuar.*

*3. Nese AK e ripercakton kete kerkese si pjese e Specifikimeve Teknike apo Termave te References, per tu permbushur gjate zbatimit posacerisht te kesaj kontrate, te rishikojne permbajtjen e informacionit dhe formatin e kerkuar duke e zevendesuar me informacionin dhe formatin qe percaktohet ne Aneks 1 si te VKM 371/2017 ashtu edhe Aneks 1 te VKM 229/2017.*

*II.6. Bazuar ne nenin 112 pika 3 te ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar ne bazen e te dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të*

dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesve.

II.7. Me shkresën nr. 18/24 prot., datë 19.02.2024, protokolluar me tonën nr. 343/3 prot., datë 22.02.2024 me objekt “Vënje në dijeni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Eco Riciklim” SHPK nëpërmjetë të cilës ka vendosur pranimin e ankesës.

*Drejtuar: OE Eco Riciklim sh.p.k*

*Me adrese: Pasuri Nr 1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh Elbasan*

*E-mail: info@ecoriciklim.al*

*Per dijeni: Komisionit te Prokurimit Publik*

*Objekti: "Eliminim i Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore", Procedure e Hapur, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj  
Fondi limit: Me fond limit 12.324,510 (dymbedhete milion e treqind e njezet e katër mije e peseqind e dhjete) leke pa tvsh.*

*Kodi sipas Fjalorit te Perbashket te Prokurimit (FPP): 90510000-5*

*REF-94567-02-06-2024*

*I mbajtur sot me date 19.02.2024 bazuar ne urdhërin Nr. 18/20 Prot, date 14.02.2024 ne lidhje me objektin e prokurimit: "Eliminim mbetjesh spitalore" me fond limit 12.324.510 (dymbedhete milion e treqind e njezet e katër mije e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh, për nje periudhe 12 muaj MK, procedure e deleguar nga Organi Qendror Blerës MSHMS, nga ankesat e ardhura ne Komisionin i Prokurimit Publik me emailin e dates 13.02.2024 Njoftim per Ankesën nga Operatori Ekonomik Eco Riciklim sh.p.k pranë Komisionit te Prokurimit Publik dhe Kerkeses per sqarim pranë AK.*

*Autoriteti Kontraktor nëpërmjet specialistit te fushes te emëruar nga ana e tij vendosi të beje ndryshimet si me poshte: Bazuar ne Ligjin e Prokurimit publik me Nr. 162/2020 Kreu XIV, neni 109, 110, 111, 113 dhe 114 si dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e rregullave te prokurimit public" neni 98, 99, 100, 101, 102, 103 dhe 104 vendosi:*

*Per OE Eco Riciklim sh.p.k te marri parasysh pranimin e plote te ankeses ne Piken 2.3.8 ne DST Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike, Shtojca 7 Formulari i Termave të Referencës pika c. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje (regjister te posacëm, minimalisht te dhenat e meposhtme):*

*a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;*

*b. sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;*

*c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;*

*d. temperaturen dhe presionin;*

- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjesim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adresë, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;
- f. te dhenat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor.*

*Si dhe ne piken 2.3 Kapaciteti teknik, te DST-ve pika 2.3.8: Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjistër te posacem, minimalisht te dhenat e mëposhtme:*

- a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;
- b. sasin ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve
- c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;
- d. temperaturën dhe presionin;
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjesim tepricate krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adrese, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore të trajtuara;
- f. te dhenat per lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor. Keto ndryshime do te reflektohen në Shtojcen per DST dhe per kete vendim do te njoftohet KPP si dhe OE i cili ka paraqitur ankimimin, për heqjen nga pezullimi AK do te presi deri ne vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi dhe zhvillimin e metejshe te procedures.*

II.8. Me shkresën nr. 232 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën nr. 343/4 prot., datë 01.03.2024 me objekt “Kërkesë”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Bazuar ne Ankesen me Nr. 343/2024 Prot, date 13.02.2024 ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne lidhje me objektin e prokurimit: "Eliminim mbetjesh spitalore" nga OE Eco Riciklim sh.p.k me NIPT L61814009B si dhe Ankesën me Nr. 342/2024 nga OE Vale Recycling NIPT: L28029301Q, AK pasi bëri shqyrtimin e ankesave dhe ndyshimet perkatëse sipas proces-verbalit me Nr. 18/21 Prot, date 19.02.2024 dhe proces-verbalit me Nr. 18/22 Prot, date 19.02.2024 ne lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: "Eliminim i Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore", Proçedure e Hapur, Marreveshje Kuadër me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj. Me fond limit 12,324,510 (dymbedhjetë milion e treqind e njetzet e kater mie e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh, me REF-94567-02-06-2024 beri ndyshimet ne shtojcen per DST. Ne si AK ju kemi vene ne dijeni me shkresën me Nr. 18/21 Prot, date 18.02.2024 si dhe shkresat bashkëlidhur ketij materiali. Kjo proçedure prokurimi është deleguar për prokurim nga Organi Qëndror Blerës Ministria e Shendetësise dhe Mbrojtjes Sociale. Gjendur perpara kushteve emergjente, pasi kontrata e*

*lidhur MK me afat 6 muaj për këte objekt prokurimi, perfundon me 29 shkurt 2024, kerkojme nga ana juaj te shikohet me përparësi dhe ne mënyre urgjente shqyrtimi i kësaj çështje. Duke ju falenderuar për bashkepunimin.*

### **III**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesve për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 18/24 prot, datë 19.02.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 342/2 prot., datë 22.02.2024 me objekt “Vënje në dijeni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Vale Recycling” SHPK, nëpërmjetë së cilës ka vendosur pranimin pjesërisht me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Drejtuar: OE Vale Recycling sh.p.k*

*Me Adrese: Fshati Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit Kurbin*

*E-mai: [recycling.vale@gmail.com](mailto:recycling.vale@gmail.com)*

*Per dijeni: Komisionit te Prokurimit Publik*

*Objekti: "Eliminim i Mbetieve te Rrezikshme Spitalore", Procedure e Hapur, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj  
Fondi limit: Me fond limit 12,324,510 (dymbedhete milion e treqind e njozet e kater mije e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh.*

*Kodi sipas Fialorit te Perbashket te Prokurimit (FPP): 90510000-5*

*REF- 94567-02-06-2024*

*I mbajtur sot me date 19.02.2024 bazuar ne urdherin Nr. 18/20 Prot, date 14.02.2024 në lidhje me objektin e prokurimit: "Eliminim mbetjesh spitalore" me fond limit 12,324,510 (dymbedhete milion e treqind e njezet e kater mije e pesëqind e dhjete) leke pa tvsh, për nje periudhe 12 muaj MK, procedure e deleguar nga Organi Qëndror Blerës MSHMS, nga ankesat e ardhura ne Komisionin i Prokurimit Publik me emailin e dates 13.02.2024 Njoftim per Ankesën nga Operatori Ekonomik Vale Recycling sh.p.k prane Komisionit te Prokurimit Publik.*

*Autoriteti Kontraktor nepermjet specialistit te fushës te emeruar nga ana e tij vendosi te beje ndryshimet si më poshte: Bazuar në Ligjin e Prokurimit publik me Nr. 162/2020 Kreu XIV, neni 109, 110, 111, 113 dhe 114 si dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e rregullave te prokurimit publik" neni 98, 99, 100, 101, 102, 103 dhe 104 vendosi: Per Vale Recycling sh.p.k te marri parasysh pranimin e pjesshem te ankesës. Per Piken 2.3.8 në DST merret parasysh e plota ankesa.*

*Shtojca 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, Shtojca 7 Formulari i Termave të Referencës pika*

*c. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjister te posacem, minimalisht te dhenat e meposhtme:*

*a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;*

*b. mbetjeve; sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;*

*c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;*

*d. temperaturen dhe presionin;*

*e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adresë, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;*

*f. te dhenat per lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshëmërise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;*

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor.*

*Si dhe në piken 2.3 Kapaciteti teknik, te DST-ve pika 2.3.8:*

*Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjister te posacem, minimalisht te dhenat e mëposhtme:*

*a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;*

*b. mbetjeve; sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;*

*c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;*

*d. temperaturen dhe presionin; e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon per asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adrese, nr. telefoni) te asgjësuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;*

*f. te dhenat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshëmërise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjësuesit te tepricave të mbetjeve spitalore;*

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi për autoritetin kontraktor.*

*Persa i perket pikes 2.1 Kapacitetin profesional te operatorëve ekonomik nuk merret parasysh nga ana e AK duke qene se plotesimi dhe pajisja nga ana e OE-ve me kete dokumentacion eshte nje detyrim ligjor dhe nuk eshte i përcaktuar nga ana e AK por nga Ministria perkatese e fushes dhe ne cdo pike eshtë e percaktuar qart baza ligjore se përse eshte kerkuara nga ana e AK pra:*

*4. Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno -Sanitar respektiv per obiektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit te mbetjeve spitalore, te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror).*

5. Vertetim qe operatori ka dorëzuar prane Agjencise Kombetare te Mjedisit, raportet e vetmonitorimeve periodike, ne zbatim te kushteve te Lejes Mjedisore qe disponon, Ligjit "Per Lejet e Mjedisit" Nr. 10448 date 14.07.2011, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.

6. Vertetim qe operatori ka kryer tarifen vjetore te Lejes Mjedisore, prane Agjencise Kombetare te Mjedisit, në zbatim te VKM nr. 417, date 25.06.2014, "Per Miratimin e Tarifave te lejeve te Mjedisit"

7. Vertetim qe operatori nuk ka mase administrative ne fuqi nga strukturat inspektuese te Agjencise Kombetare te Mjedisit, në zbatim te Ligj Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise", Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr. 10448 date 14.07.2011 si dhe Ligjit Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"

Per sa me sipër ju bejme me dije se nga ana e AK jemi bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" Kreu XI, Neni 77, pika 4 si dhe VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" Seksioni III "Kerkesa te Veçanta sipas Tipeve të Kontratave", Neni 42 Kerkesa te veçanta per kontratat e shërbimeve" pika 5 germa c dhe pika 6.

Keto ndryshime do te reflektohen ne Shtojcen për DST dhe per këte vendim do te njoftohet KPP si dhe OE i cili ka paraqitur ankimin, per heqjen nga pezullimi AK do te presi deri ne vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi dhe zhvillimin e metejshtëm te procedures.

III.1.2. Me shkresën nr. 18/24 prot., datë 19.02.2024, protokolluar me tonën nr. 343/3 prot., datë 22.02.2024 me objekt "Vënje në dijeni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë "Eco Riciklim" SHPK nëpërmjetë të cilës ka vendosur pranimin e ankesës.

Drejtuar: OE Eco Riciklim sh.p.k

Me adrese: Pasuri Nr 1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh Elbasan

E-mail: info@ecoriciklim.al

Per dijeni: Komisionit te Prokurimit Publik

Objekti: "Eliminim i Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore", Procedure e Hapur, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj  
Fondi limit: Me fond limit 12.324,510 (dymbedhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) leke pa tvsh.

Kodi sipas Fjalorit te Perbashket te Prokurimit (FPP): 90510000-5

REF-94567-02-06-2024

I mbajtur sot me date 19.02.2024 bazuar ne urdhërin Nr. 18/20 Prot, date 14.02.2024 ne lidhje me objektin e prokurimit: "Eliminim mbetjesh spitalore" me fond limit 12.324.510 (dymbedhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) leke pa tvsh, për nje periudhe 12 muaj MK, procedure e deleguar nga Organi Qendror Blerës MSHMS, nga

*ankesat e ardhura ne Komisionin i Prokurimit Publik me emailin e dates 13.02.2024 Njoftim per Ankesën nga Operatori Ekonomik ECO RICIKLIM sh.p.k pranë Komisionit te Prokurimit Publik dhe Kerkeses per sqarim pranë AK.*

*Autoriteti Kontraktor nëpërmjet specialistit te fushes te emëruar nga ana e tij vendosi të beje ndryshimet si me poshte: Bazuar ne Ligjin e Prokurimit publik me Nr. 162/2020 Kreu XIV, neni 109, 110, 111, 113 dhe 114 si dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Miratimin e rregullave te prokurimit public" neni 98, 99, 100, 101, 102, 103 dhe 104 vendosi:*

*Per OE Eco Riciklim sh.p.k te marri parasysh pranimin e plote te ankeses ne Piken 2.3.8 ne DST Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike, Shtojca 7 Formulari i Termave të Referencës pika c. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje (regjister te posacëm, minimalisht te dhenat e meposhtme):*

- a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;*
- b. sasine ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve;*
- c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;*
- d. temperaturën dhe presionin;*
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjесim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adresë, nr. telefoni) te asgjесuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore te trajtuara;*
- f. te dhenat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjесuesit te tepricave te mbetieve spitalore;*

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor.*

*Si dhe ne piken 2.3 Kapaciteti teknik, te DST-ve pika 2.3.8: Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron ne nje regjistër te posacem, minimalisht te dhenat e mëposhtme:*

- a. numrin e identifikimit te ciklit te trajtimit;*
- b. sasin ditore, llojin e mbetjeve te trajtuara dhe kodin perkates sipas katalogut shqiptar te mbetjeve*
- c. daten, oren e fillimit dhe mbarimit te ciklit te trajtimit;*
- d. temperaturën dhe presionin;*
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorezon per asgjесim tepricate krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe te dhenat e kontaktit (emer, mbiemer, adrese, nr. telefoni) te asgjесuesit te ketyre tepricave te mbetjeve spitalore të trajtuara;*
- f. te dhenat per lejen e mjedisit A dhe/ose B, te licences III.2.B (vlefshmerise se tyre) dhe Kodin Unik te asgjесuesit te tepricave te mbetjeve spitalore;*

*Te hiqet pasi nuk eshte kusht skualifikimi per autoritetin kontraktor. Keto ndryshime do te reflektohen në Shtojcen per DST dhe per kete vendim do te njoftohet KPP si dhe OE i cili ka*



*paraqitur ankimimin, për heqjen nga pezullimi AK do të presi deri në vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi dhe zhvillimin e metejshëm të procedurës.*

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë

e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore*”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

